



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspeksionit
Glllogoc, me 04.10.2017



RAPORT PËR MUAJIN SHTATOR 2017

Gjatë këtij muaji kemi vazhduar me rëndësi të veçantë inspektimin e Institucioneve Arsimore për shkak të fillimit të vitit të ri shkollor, bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë në Drenas për taksë komunale dhe Inspektime të transportit ilegal. Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektori Sanitar ka inspektuar ato shkolla në të cilat ka hasë në parregullsi në inspektimet e kaluara si dhe inspektime të zakonshme në subjektet afariste rreth afatizimit të produkteve ushqimore dhe kushtet higjienike.

Inspektori i Ndërtimit ka vazhduar me kontrollë të ndërtimeve pa leje dhe është bërë rrënimi i 2 objekteve (në pronë Komunale) përmes Kompanisë kontaktuese (objekte të stacioni i vjetër i autobusave).

Inspektori i Komunikacionit ka bërë kontrollë të Operatorëve ilegal duke vazhduar me masat ndëshkuese-fletëparaqitje dhe konfiskim të targave të automjeteve.

Inspektorët e Tregut kanë inspektuar në veqanti tregtarët lëvizës dhe largimin e tyre nga shitja në vendin jo adekuat si dhe janë urdhëruar bizneset për tu pajisur me pëlqim për ushtrimin e veprimtarisë.

Inspektori Financiar ka vazhduar me inspektim të bizneseve rreth kryerjes së obligimeve të takses komunale.

Inspektori i Ambientit ka kryer inspektime në shqyrtim të kërkesave të qytetarëve si dhe urdhëresë për ato subjekte të cilat nuk janë kyqur në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Në vazhdim po paraqesim një pasqyrë të punes në shifra për muajin shtator 2017:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktvendime	Fletëparaqitje	Gjoha mandat.	Kërkesa	Pëlqim për biznes	Shqyrtim i Kërkesave	Rrënim i objekteve	Konfiskim i Tab.automjeteve
I.Sanitare	19	3			5	4	5		
I.Tregut	6	3			3	3	3		
I.Financiare	31								
I.komunikacionit	14		3						5
I.Ndërtimit	9	4			1		1	2	
I.Ambientit	31			1	8		8		
Gjithsej	110	10	3	1	17	7	17	2	5

Tetor 2017

Shef i Inspektionit: ARIANA SADIKU